

REPUBLIKA E SHQIPËRISE

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVATË

Shoqëria "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k. Nipt L81722046V

Rruga "Vaso Pasha" Nr.13/1, Ap.1, Tirane E-mail: [elvinth@hotmail.com](mailto:elvinth@hotmail.com) Mob: +355682029920

Nr.320 Dosje

Nr.336 Prot.

Tiranë më datë 25/6/2018

URDHËR

(PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)



Drejtuar : QËNDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Per Dijeni : Debitorit , Shoqërisë "MEDIA NORD" sh.a Nr.Nipt K66531001W  
Kreditorit , Autoriteti I Mediave Audiovizive (AMA)

Unë Elvin Gëzim Hoxha me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Shoqërisë së Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në referim të Vendimit Urdhër Ekzekutimi Nr.563 datë 05.10.2017 lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë për Titullin Ekzekutiv Vendim Nr.75 datë 10.05.2017 të AMA-s, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.320, Datë 12.06.2018 kërkesën e kreditorit Autoriteti I Mediave Audiovizive (AMA) për vënie në ekzekutim ndaj debitorit Shoqërisë "MEDIA NORD" sh.a Nr.Nipt K66531001W për subjektin radiofonik vendor privat "Radio Grant".

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Shoqërisë "MEDIA NORD" sh.a Nr.Nipt K66531001W për subjektin radiofonik vendor privat "Radio Grant" , Lajmërimin Nr.3148 Prot, Datë 12.06.2018, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban titulli ekzekutiv sebashku me tarifen e shërbimit përmbarimor, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile.

Ne kushtet kur për ekzekutimin e Urdhërit të Ekzekutimit, nuk është përmbushur detyrimi në mënyrë vullnetare, nga ana e Përmbaruesit Gjyqësor Privat duhet të kryhet vendosja e masës së sekuestros konservative në kuotat/aksionet e pales debitore, në zbatim të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile dhe ligjit nr.10031 , datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat"

URDHËROJ

1-Vendosjen e masës së sekuestros konservative në kuotat/aksionet e palës debitore, si dhe mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat në regjistrin tregtar. Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë nga Përmbaruesi Gjyqësor Elvin Hoxha .

Shoqëria "MEDIA NORD" sh.a Nr.Nipt K66531001W për subjektin radiofonik vendor privat "Radio Grant" me adresë të selisë Lagjia Qemal Stafa , pranë TV1 , Shkodër

- 2- Për veprimet apo mos veprimet tuaja duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor
- 3- Personat që behen pengesë , do të përgjigjen në bazë të nenit 606 K.Pr.Civile (paragrafi II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobes dhe kallezimit penal.
- 4- Ky urdher mbahet në disa kopje dhe u njoftohet paleve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 (pese) diteve.

SHOQËRIA E PËRMBARIMIT PRIVAT "BAILIFF SERVICE E.HOXHA"sh.p.k.  
PËRMBARUES GJYQËSOR  
ELVIN HOXHA